



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	01-111/01-0002319/24
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	3
Data Datum Date	23/02/2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

Komuna e Mitrovicës Veriore

Nr. _____.

Data: 23.02.2024.

Mitrovicë Veriore.

Bazuar në nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, dispozitave të Statutit të Komunës, dhe vendimit të Kuvendit Komunal të Mitrovicës Veriore Nr. 01-02-031 të datës 03.01.2024, Komisioni për përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Mitrovicës Veriore, me datë 23.02.2024 shpall:

K O N K U R S
(Për dizajnimin e Stemës së Komunës së Mitrovicës Veriore)

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë personat fizik dhe juridik, rezident dhe jo rezident të Republikës së Kosovës, e të cilët nuk janë anëtarë të komisionit për dizajnimin e stemës apo komisionit profesional për përzgjedhjen e punimeve më të mira, apo që këto komisione i kanë angazhuar në punën e tyre.

Propozimi për zgjidhje ideore të Stemës së Komunës së Mitrovicës Veriore, duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03-L-040 dhe Statutin e Komunës së Mitrovicës Veriore, të i'u përgjigjet karakteristikave historike, kulturore, natyrore dhe karakteristikave tjera të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Propozimi nuk mund të ketë formë të njëjtë apo të modifikuar me simbolet shtetërore dhe nacionale të Kosovës apo shteteve tjera, me logot e partive politike, shoqërive tregtare, institucioneve, subjekteve tjera juridike dhe organizative.

Kriteret e përgjithshme për hartimin e zgjidhjes ideore të Stemës:

- Numri, paraqitja dhe përmbajtja e fushave në modelin e propozuar të Stemës duhet të jetë e përshtatshme për praktikën heraldike;
- Stema duhet të punohet në dy variante themelore (e ashtuquajtura stema e vogël) dhe të zgjeruar, respektivisht zyrtare (e ashtuquajtur stema e mesme);
- Renditja dhe përmbajtja e fushave në mburojë duhet t'i plotësojnë kushtet e praktikës heraldike dhe përmbajtja e tyre duhet të përputhet me kërkesat nga pika e konkursit;
- Stema e zgjeruar – zyrtare duhet të ketë mbishkrimin me tekstin Mitrovica Veriore;

- e) Trajta dhe forma e stemës duhet të mundësoj teknikën e printimit në disa ngjyra dhe që stema, si simbol mund të përdoret për punimin e pllakave, diplomave, shenjave, mirënjohjeve publike, suvenireve dhe të ngjashme.

Kushtet e veçanta:

- a) Vizatimet që paraqesin propozimin për Stemë duhet të bëhen me ngjyra dhe të paraqiten në fleta të veçanta të formatit A4;
- b) Secila nga fletët që përmban propozimet duhet të jetë e shënuar individualisht me një kod dhe një numër;
- c) Në fletë të formatit A4 duhet të dorëzohet varianti 'bardh-zi' i të njëjtës;
- d) Në fleta të veçanta të formatit A4 duhet të dorëzohen shembuj të detajuar me aplikimin e stemës së propozuar në memorandumë, zarfe postare dhe kartëvizita;
- e) Teknika e bërjes së propozimit mund të jetë edhe me dorë por me ngjyrë (teknikat: dush, temper, bojra uji ose një kombinim i këtyre teknikave);
- f) Përveç dorëzimit të vizatimeve në letër, propozimi paraqitet edhe në formë elektronike në CD në mënyrë që kodi dhe numri i vizatimeve të shënohen në vetë CD-në dhe në paketimin e saj;
- g) Me vizatime është e domosdoshme të bashkëngjitet një përshkrim tekstual se çka përfaqëson secila ngjyrë apo secili detaj i Stemës.

Afati i dorëzimit të propozimeve, zgjedhja e tyre dhe shpërblimet:

- a) Punimet dorëzohen në pako (zarf) me KOD, më së largu deri në ora 16:00 të ditës së fundit të konkursit në adresën: **Komuna e Mitrovicës Veriore, Rr. Nemanjina 40000 Mitrovicë Veriore**, me mbishkrimin: **Konkursi për Dizajnimin e Stemës së Komunës së Mitrovicës Veriore**;
- b) Me punim, në zarf të veçantë të mbyllur është e nevojshme të dorëzohen edhe të dhënat personale të pjesëmarrësve (emri dhe mbiemri, adresa e banimit dhe numri i telefonit) si dhe deklaratën e nënshkruar të autorit që nëse ai shpërblehet, e drejta e autorit transferohet automatikisht tek Komuna e Mitrovicës Veriore dhe se propozimi i ofruar është krijim personal i autorit;
- c) Konkursi zgjatë 30 ditë nga dita e publikimit deri me datë 23.03.2024.

Shpërblimet e propozuara janë si vijon:

- a) Shpërblimi i parë 2000 €
- b) Shpërblimi i dytë 1000 €
- c) Shpërblimi i tretë 500 €

Kushtet e konkursit:

- a) Çdo pjesëmarrës i konkursit mund të marrë pjesë me më së shumti tri punime. Çdo punim duhet të i'u dorëzohet komisionit si dërgesë (punim) i veçantë dhe me kod të veçantë dhe përmbajtje të kërkuar;
- b) Punimet të cilat arrijnë pas skadimit të afatit prej 30 ditësh, nga dita e publikimit të konkursit, nuk do të shqyrtohen;
- c) Propozimet e pakompletuara sipas konstatimit të komisionit nuk do të shqyrtohen.


Erden ATIQ
Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore